



**Ne bëjmë diçka
kundër racizmit!**

**Rinia e sindikatës Unia kundër racizmit
dhe ksenofobisë. Një doracak praktik.**

Shkurtesat:

AVIG: Ligji mbi sigurimin në rast papunësie

BIZ: Qendra për informim në lidhje me profesionet

BV: Kushtetuta federale

EU: Bashkimi Evropian

GAV: KPP, Kontrata e përgjithshme e punës

OR: E drejta e obligacioneve

SGB: BSZ, Bashkimi Sindikal i Zvicrës

StGB: Kodi penal

Ky doracak është botuar në gjuhët: Shqip, Gjermanisht, Frëngjisht, Italisht, Spanjisht, Portugalisht, Serbokroatisht, dhe Turqisht. Mund të porositet në adresën: Zentralsekretariat, Migrationspolitik, Weltpoststrasse 20, CH-3000 Bern 15 migration@unia.ch; T +41 31 350 21 11, Dizajni: Simone Rolli, Shtypshkronja: Printoset Zürich, © Unia, dhjetor 2005

Përmbajtja

Hyrje	4
Askush nuk është racist, apo?	6
Çka është racizmi?	8
Si të këshilloj viktimat e diskriminimit racial?	14
Vetë jam viktimë: çka të bëj?	16
Diskriminimi gjatë shkollimit dhe ngritjes profesionale	18
Racizmi në shkollën profesionale	20
Racizmi në vendin e punës	22
Racizmi nga ana e klientëve	25
Racizmi në rrethin e ngushtë	26
Diskriminimi në pagë	27
Unë jam dëshmitar!	28
Ligjet kundër diskriminimit racial	30
A ia vlen të ndërmerren hapa ligjorë?	36
Adresat e rëndësishme	38
Ne mbrohemi!	43

Hyrje

Si sekretar sindikal apo aktivist i ri sindikal sigurisht se je ballafaquar me diskriminimin racial. Ose je kontaktuar nga ndonjë i ri, kolegë pune apo mik, i cili ka kërkuar ndihmën tënde, ose ke qenë vetë viktimë e diskriminimit. Në këtë rast, sigurisht, ia ke parashtruar vetes pyetjen: Ishte ky vërtetë racizëm? Çka mund të bëj kundër racizmit? Si mund të ndikoj që të mos ndodhë më? Si ta luftoj? Kujt mund t'i drejtohem? Si mund të vijë deri te e drejta ime?

Për fat të keq, rastet e racizmit dhe diskriminimit janë duke u shtuar edhe te të rinjtë, në sindikatë dhe në grupe rinore. Ksenofobia bëhet e aftë për sallon (normalitet i modës). Në një shoqëri demo-

kratike nuk duhet të ekzistoj racizmi dhe diskriminimi, sepse i rrezikon të drejtat qenësore të njerëzve dhe dinjitetin e tyre. Për këtë arsye, të gjithë ata të cilët duan të angazhohen për një shoqëri të drejtë dhe demokratike duhet të angazhohen kundër racizmit, ta luftojnë edhe mënjanojnë atë.

Ky doracak duhet të të ndihmojë për të vërejtur racizmin në vendin e punës, shoqëri dhe arsim dhe për ta luftuar atë me efikasitet. Këtu gjen edhe këshilla dhe adresa, të cilat mund t'i konsultosh në rast nevojë.

Unia, Sindikata jote.

Në të vërtetë askush nuk është racist, apo?

Gati askush nuk pranon haptas se është racist. Po t'i thuash dikujt: «Këtë që thua ti është shprehje raciste», atëherë ky do të mohoj këtë me këmbëngulje. Pastaj fillojnë diskutimet mbi atë, se çka është racizmi? Do të parashtrohet menjëherë pyetja: «A guxon njeriu të thotë diçka kritike, pa u akuzuar se është racist?».

Kjo pyetje nuk është patjetër pa vend, sepse shpesh mungon vetëdija për problemin dhe mbretëron edhe rrëmujë e definicioneve: Racizëm, armiqësi ndaj të huajve, Ksenofobi, Antisemitizëm, Nacionalizëm etj., shpesh përzihen. Këtu ekziston nevoja për sqarim të definicioneve.

Një grua: «Unë nuk jam raciste, por këta Jugo të poshtër, më kupton ...»

Një kolegë shegert i thotë Zhan A. Nga Kameruni: «Të zitë nuk mund t'i duroj hiq. Ti je diçka tjetër, se ty të kam shok»

Një sindikalist: «Kurrsesi nuk jam racist. Racistët bile i urrej, mirëpo ne mund të kujdesemi që vendet e punës të rezervohen për zviceran».

Çka është racizmi?

Ai, i cili, një person e trajton ndryshe vetëm e vetëm se ka ngjyrë tjetër të lëkurës ose vjen nga një vend tjetër apo i takon ndonjë besimi tjetër, vepron si racist.

Diskriminimi është veprim: Diskriminimi është lënie anash e një personi në bazë të ngjyrës së lëkurës, prejardhjes kulturore apo sociale, gjinisë, moshës apo besimit fetar.

Racizmi është qëndrim: Për racizëm flitet atëherë kur njerëzit për shkak të prejardhjes dhe ngjyrës së lëkurës diskriminohen, vihen në pozitë të keqe ose thjeshtë injorohen

Me diskriminim racial kemi të bëjmë, nëse njeriu për shkak të ngjyrës së lëkurës, gjuhës, apo fesë nuk mund t'i realizojë të drejtat e tija. Për të diskriminuar në baza raciale nuk duhet patjetër të ekzistojë ndonjë bindje e fortë raciste; secili është në gjendje të bëjë këtë. Viktima janë edhe të huajt por edhe zviceranët.

Ksenofobia kështu quhet frika prej të huajve. Shpesh përkthehet si «armiçësi kundër të huajve».

Antisemitizmi: Antisemit është ai, i cili diskriminon, keqtrajton, injoron apo fyen një person me prejardhje çifute. Si antisemit vepron edhe ai, i cili mohon holok-austin (krimet kundër çifutëve në kohën e fashizmit) dhe fajëson çifutët e Zvicrës për politikën e qeverisë së Izraelit.

Nacionalizmi përshkruan ideologjinë politike, e cila famën, mirëqenien, fuqinë dhe superioritetin e kombit të vet e vë në qendër. Nacionalisti e stërmadhon kombin të cilit i takon në krahasim me kombet tjera. Nacionalizmi nuk mund të krahasohet me racizmin, por mund të qoj deri te ai.

Listën e definicioneve të shumta mund ta gjesh nën www.gggfon.ch.



Hej, është i gjithë ky racizëm?

Nuk është lehtë të cilësosh ndonjë veprim si veprë raciste apo diskriminuese, sidomos atëherë kur personi i cili vepron në mënyrë raciste është i afërt me ty.

Nëse dyshon, se a bëhet fjalë për racizëm, atëherë parashtroja vetes – nga këndvështrimi i viktimës – këtë pyetje: A do të trajtohesha ndryshe, po të kisha pasur ngjyrë tjetër të lëkurës, prejardhje, gjuhë apo fe tjetër? Nëse përgjigja është po, atëherë kemi të bëjmë qartë me diskriminim racial.

Diskriminimi racial mund të shprehet haptazi dhe fshehtazi

Diskriminimi racial i cili shprehet haptas ndodhë shumë rrallë, sepse keqbërësi ka frikë prej pasojave ligjore. Ky lloj racizmi zbulohet lehtë dhe ndiqet penalisht, siç tregojnë këta dy shembuj:

«**Nuk punësojmë shamia**», shkruan një punëdhënës i tërbuar në adresë të Qendrës për ndërmjetësim në rast papunësie (RAV) në Cyrih. Unia e përfaqëson zviceranën, me prejardhje nga Maqedonia, para gjyqit dhe fiton procesin. Viktimës i ndahet një dëmshpërblim.

«**Për këtë vend shkollimi në profesion kemi paraparë një të ri të shkathët dhe ndërgjegjes. Vetëm zviceranë dhe shtetas të BE-së.**» Ka edhe më keq. Kur p.sh. në shpalljet për konkurrim shkruhet: «**Nuk duam të rinj nga Ballkani**».

Racizmi i fshehur është vështirë të dëshmohet, sepse personi i cili diskriminon, veprën e tij e fsheh mirë. Mu te kjo formë e racizmit, njerëzit shpesh nuk janë të vetëdijshëm se diskriminojnë. Mirëpo, edhe te kjo formë e racizmit vlen: çfarë ndjenjash lindin te vik-tima dhe cilat janë pasojat?

Si të këshillojë viktimat e racizmit?

Është me rëndësi që viktima të ketë mundësi, që me fjalët e veta, të përshkruaj se si ndihet, a e ndjen veten të lënduar apo keqtrajtuar. Këtij personi duhet dhënë kurajë për të vepruar. Së pari duhet ndihmuar të gjej një person të besueshëm (kolegë, mik, shok) i,e cili/a mund të ndihmojë. Është me rëndësi që viktima të mos e ndjejë veten të vetmuar, nëse vendosë të luftojë padrejtësinë.

Nuk duhet të sulmohet menjëherë dhe pa u menduar: Me keqbërësin duhet kërkuar dialogu, për të qenë në gjendje, që pa paragjykime dhe me fakte, të sqarohen motivet e tija të vërteta. Duhet ikur asaj, që të ballafaqosh atë menjëherë me akuzën se është racist.

Vepro hap pas hapi: Sqaro lëndën, dëgjoji të dy palët, mos akuzo! Edhe pse është tejet me rëndësi marrja me seriozitet e ndjenjave të «viktimës», pa e marrë parasysh edhe këndvështrimin e «keqbërësit» vështirë se mund të gjinden zgjidhje. Gjithmonë duhet konsideruar edhe mundësinë e akuzimit të pa bazë.

Angazhimi kundër racizmit të vërtetë ia vlen gjithmonë! Mirëpo, pasi që në Zvicër mungon mbrojtja kundër pushimit nga puna, lufta kundër rastit me tipare raciste mund të qoj deri te humbja e vendit të punës -edhe pse viktimë ka të drejtë. Kjo duhet të jetë e qartë prej fillimit. Pra, merri në konsideratë edhe pasojat e mundshme dhe jepi mundësi viktimës, që ai/ajo të zhvillojë strategjinë e vet dhe të jetë i/e vetëdijshme mbi pasojat e mundshme.

Jam vet viktimë: çka të bëj?

Bisedo me koleget dhe kolegët mbi ngjarjen, krijoni strategjinë e përbashkët apo bëjeni temë bisede në klasë dhe rrethin tuaj. Gjithashtu ekzistojnë grupe të ndryshme kundër racizmit (p.sh. Rinia e Sindikatës Unia, krahaso edhe listën në faqen 41 të këtij doracaku) të cilat ju ndihmojnë për tu angazhuar në mënyrë aktive kundër racizmit dhe për t'i bërë publike rastet e tilla.



Diskriminimi gjatë shkollimit dhe ngritjes profesionale

Dardani, një i ri nga Kosova, lajmërohet në Qendrën për Informacione mbi Profesionet dhe kërkon një formular për regjistrim në gjimnaz. Këshilltarja i thotë: «Mirëpo, Gjimnazi është vetëm për nxënës të mirë», dhe atë pa i parë dëftesat e Dardanit. Dardani pyet veten: «Do të më kishte ndodhur kjo, po të isha zviceran?»

Çka duhet bërë?

Dardani mund ta pyes këshilltaren: «Pse thoni një gjë të tillë. A mos jeni e mendimit se nuk jam nxënës i mirë vetëm pse jam i huaj?» Në këtë rast, Dardani duhet patjetër të ndjekë qëllimin e tij për të shkuar në gjimnaz dhe me këmbëngulje të kërkoj formularin për regjistrim. Dardani mund ta përshkruaj atë çka i ka ndodhur edhe në faqen e internetit www.ncbi.ch gjermanisht, ose www.ciao.ch frëngjisht se vetëm kështu mund të bëhen publike rastet e tilla.

Sandra, zvicerane, dhe Fatima, nga Algjeria konkurrojnë për vendin e njëjtë për shkollim në profesion të tregtisë. Ato e kanë ndjekur të njëjtën shkollë dhe i kanë ndihmuar njëra tjetrës në kompletimin e dosjes për aplikim. Dosjet e tyre janë të njëjta. Fatima i ka bile edhe notat më të mira se Sandra. Por, pranohet vetëm Sandra, kurse Fatima as që ftohet për bisedë.

Çka duhet bërë?

Fatima duhet të kontaktoj ndërmarrjen dhe të kërkoj një bisedë mbi arsyet e refuzimit. Është vështirë për të dëshmuar, se Sandrës i është dhënë përparësi vetëm pse është zvicerane. Për Fatimen është më së miri t'i drejtohet degës për çështje juridike në Unia, për të sqaruar mundësitë e marrjes së masave ligjore kundër ndërmarrjes. Në rast të diskriminimeve gjatë kërimit të vendeve për përgatitje profesionale mund të ndihmojë edhe këshillimorja «Fairness».

Racizmi në shkollën e profesioneve

Hoze bën shkollën e profesionit në një punëtori për përpunimin e metaleve. Punimi aktual duhej të vlerësohej. Kolegu dhe fqinji i tij Beati e merr pa dashje punimin e Hozes dhe ia tregon mjeshtërit. Mjeshtri ia jep notën 6. Beati e vëren gabimin dhe i tregon Hozesë. Ky shkon me të njëjtin punim te mjeshtri, i cili pa e shikuar si duhet punimin ia jep Hozesë notën 4.5. Hoze ia përkujton mjeshtrit, se të njëjtin punim para pak çastesh e kish vlerësuar me notën 6. Mjeshtri i thotë, se nuk do të diskutoj mbi vlerësimin e tij. Edhe pas dëshmimit të Beatit ai mbetet kokëfortë.

Çka duhet bërë?

Diskriminimi shpesh ka të bëj me fuqinë dhe pafuqinë. Në këtë rast, mjeshtri është në pozitë të fuqishme dhe e (keq)përdor atë. Hoze mund të kërkoj ndihmën e Beatit që së bashku të shkojnë te drejtoria e shkollës dhe të përshkruajnë ngjarjen- mundësisht me fakte. Me rëndësi është edhe dokumentimi i rastit. Të vlefshme janë protokollet, shënimet personale ose edhe këmbimi i letrave në lidhje me rastin. Nëse mjeshtri nuk ndërron mendimin dhe shkolla nuk ndërmerr asgjë, atëherë Hoze mund të qoj rastin deri te instancat më të larta të arsimit. Edhe padia në gjyq është e mundshme. Nëse Hoze është anëtarë i sindikatës atëherë ai i drejtohet degës për çështje juridike në Unia ose kontakton TikK-un në Zvicrën gjermane, gjegjësisht ACOR-in në Zvicrën franceze.

Racizmi në vendin e punës

Miroslavi: «Në ndërmarrje gjithmonë dëgjoj thënie negative kundër vendasve të mi. Ndonjëherë tentoj të buzëqesh, ndonjëherë i them vetvetes se këta njerëz që flasin keq janë të marrë dhe se çdo kund ka njerëz të mirë dhe të këqij. Me kalimin e kohës më nuk mund t'i duroj këto thënie. Kjo më streson dhe filloj t'i shikoj kolegët e mi si racistë. Nuk guxoj të them apo të ndërmarr diçka nga frika se mund të izolohem apo të humb vendin e punës».

Çka duhet bërë?

Është me rëndësi që Miroslavi të mos lejojë që këto thënie të i drejtohen atij, pa pasur mundësi të reagoj. Ai duhet t'ia bëj të qartë kolegëve se këto thënie e lëndojnë. Nëse kjo nuk tregon rezultate, atëherë ai duhet t'i drejtohet shefit apo komisionit të ndërmarrjes ose degës për çështje të personelit.

Ai, i cili i nënshtrohet thënieve të tilla raciste, mund të sëmuret. Nëse Miroslavi nuk gjen për-krahje në ndërmarrje, atëherë ai duhet t'i drejtohet sindikatës. Ai mund të kontaktoj TikK-un në Zvicrën gjermane, gjegjësisht ACOR-in në Zvicrën franceze.



Racizmi prej klientëve

Një mysafir i rregullt i thotë pronarit të restorantit me zë të lartë, që ta ndiej edhe Aimé, kamerieri me ngjyrë të mbyllët të lëkurës: «Shpresoj se mishi i pjekur nuk është djeg dhe nxi sikur ky kamerieri yt!»

Çka duhet bërë?

Klienti i rregullt e keqpërdor pozitën e tij superiore, sepse asnjë pronar i restorantit nuk ka dëshirë të humb një myshteri të mirë. Kamerieri Aimé mund të kërkoj nga pronari, që ai ta mbrojë nga diskriminimi racist nga klientët. Aimé mund ta lus pronarin, që ai t'ia tërheq vërejtjen klientëve dhe tua bëj me dije se këto shprehje fyejnë punëtorin e tij.

Ndodhë që punonjësit të rrezikojnë humbjen e vendit të punës apo transferimin në një vend tjetër ku nuk kanë më kontakt me klientët. Nëse ndodhë një gjë e tillë, atëherë Aimé mundet, që me ndihmën e sindikatës të ndërmarr hapa ligjorë.

Racizmi në rrethin e ngushtë dhe shoqëri

Markusi tregon një barsoletë (vic, shaka) mbi të huajt: «Në një automobil janë të ulur një turk, një jugo dhe një zezak. Kush e nget automobilin? Polici!». Ai i thotë shokut të tij Hakimit: «E di, se ndoshta kjo barsoletë të lëndon, por mu desh patjetër të ta tregoj se është aq qesharake!»

Çka duhet bërë?

Në këtë rast është e nevojshme që sqarohet dhe haptas të thuhet, se një gjë e tillë lëndon. Thënie sulmuese si «Ti je racist!» ose reagim i dhunshëm apo kërcënim, sigurisht se nuk kontribuojnë në përmirësimin e situatës. Nga ana tjetër, nëse menjëherë i shpreh ndjenjat e tua, atëherë në mesin e shokëve mund të bisedohet me argumente dhe pa emocione. Porosite broshurën e vizatuar «Ich Rassist?!» pranë Stiftung Bildung und Entwicklung (5.- frang, porosia mund të bëhet edhe nëpërmjet i-melit: laden@globaleducation.ch).

Diskriminimi në pagë

Në Zvicër askush nuk flet mbi rrogën e tij. Manueli dyshon se paguhet më pak se sa kolegët e tij, sepse është i huaj, edhe pse ka të njëjtat kualifikime. Mirëpo, nuk di se si ta zbuloj këtë.

Çka duhet bërë?

Nëse dega e tij i nënshtrohet KPP-së, atëherë ai mund të pyes në Unia, se cilat paga janë të para para me KPP. Përndryshe ai mund të konsultoj edhe llogaritësin e pagës të BSZ-së www.lohn-sgb.ch. Aty ai mund të shënoj ngritjen profesionale, kualifikimet, vendin e punës, degën e ekonomike dhe në bazë të këtyre të dhënave bëhet llogaritja e pagës së zakonshme për degën dhe regionin e tij. Nëse paga e tij nuk përputhet me atë të cilën e parasheh llogaritësi, atëherë ai duhet të bisedoj me shefin e tij. Si anëtarë i sindikatës mund ti drejtohet seksionit të sindikatës Unia dhe të bisedoj më përpara me sindikatën.

Unë jam dëshmitarë

Jam dëshmitarë i një diskriminimi racial, por nuk jam i kyçur drejtpërsëdrejti. A mund të bëj diçka?

Çka duhet bërë?

Është me rëndësi që të mos jemi indiferent, sepse racizmi është i rrezikshëm për çdo shoqëri! Edhe si dëshmitarë duhet të veproh kundër racizmit dhe të inkurajosh viktimën, që ajo të veproj dhe të mbrohet. Nëse ti e përkrah, atëherë viktima ka më shumë guxim të mbrohet. Me rëndësi është edhe qitja në shesh e rasteve të racizmit. Këtu mund të marrësh ndihmë nga Unia për të rinj dhe grupet që luftojnë kundër racizmit. Presioni publik është mjeti më i përshtatshëm kundër diskriminimit racial. Kjo quhet edhe guxim civil! gggfon ofron këshilla konkrete të veprimit në lidhje me guximin civil.



Ligjet kundër diskriminimit racial

Neni 8 i Kushtetutës federale nën «barazia ligjore», thotë:

1 Të gjithë njerëzit janë të njëjtë para ligjit.

*2 Askush nuk guxon të diskriminohet për shkak të prejardhjes, racës, gjinisë, moshës, gjuhës, pozitës shoqërore, mënyrës së jetesës, të fesë, botëkuptimeve apo bindjeve politike si dhe për shkak të metave trupore apo psikike.
(...)*

Hopa, tash të zumë, racist! Për ty tash kujdeset ligji!?!

Na vjen keq, por ligjet zvicerane shumë dobët e luftojnë racizmin. Ne, sindikatat, punojmë në përmirësimin e ligjeve kundër racizmit, dhe që racizmi të mos mbetet më «delikt kavalieri». P.sh. ne kërkojmë futjen e një neni kundër diskriminimit në KPP, bashkëpunojmë me grupet e ndryshme të cilat e luftojnë racizmin, angazhohemi për ashpërsimin e ligjit kundër racizmit, organizojmë aksione dhe qesim në shesh rastet e diskriminimit racial.

Prapëseprapë ligji ofron disa mundësi për t'u mbrojtur:

Neni	Çka thotë ligji?	Mirëpo, kujdes!
Kushtetuta, Neni 8	Para ligjit të gjithë jemi të barabartë, askush nuk guxon të diskriminohet. www.ekr-cfr.ch > Themen > rechtliche Grundlagen > Bundesverfassung	Ky nen i kushtetutës, për fat të keq, nuk zbatohet plotësisht: P.sh. nuk kemi ligje kundër diskriminimit. Unia angazhohet për këtë.
Kodi penal 261 deri (ashtu- quajtur normë penale kundër racizmit)	Ai, i cili publikisht bën shprehje raciste apo diskriminon në baza raciale do të ndëshkohet. www.ekr-cfr.ch > Themen > rechtliche Grundlagen > Antirassismus Strafnorm	Është shumë vështirë, që edhe racistët më të këqij të ndëshkohen. Shprehjet raciste në rrethin privat nuk ndëshkohen. Këshillohu nga një specialist (p.sh. Jurist). Afati i ngritjes së padisë është i shkurtë.

Neni	Çka thotë ligji?	Mirëpo, kujdes!
OR 328	<p>Ndërmarrja është e detyruar të të mbrojë kundër racizmit- edhe nga klientët apo kolegët.</p> <p>www.gewerkschaftsjugend.ch > Lehrlingsrechte A-Z > Persönlichkeitsschutz</p>	<p>Është vështirë të detyrosh punëdhënësin të bëj diçka. Nise procedurën ligjore vetëm nëse je i sigurt se nuk «rrezikon» veten. Kujdes efekti i bumerangut. (krahaso më poshtë «AVIG 16»)</p>
OR 336 rendi. 1a	<p>Nëse largohesh nga puna për arsye raciste, atëherë largimi është abuzues:</p> <p>Informacione: www.alk.unia.ch > arbeitslos: was tun? > Kündigung www.unia.ch > Arbeit & Recht > Hintergrund Recht > Kündigungsschutz</p>	<p>Sipas rregullit, largimi nga puna nuk mund të anulohet, mirëpo ti ke të drejtë pagese në formë të dëmshtëpërblimit prej më së shumti 3–6 muaj. Kujdes: të duhen prova!</p>

Neni	Çka thotë ligji?	Mirëpo, kujdes!
OR 337	Nëse je viktimë e racizmit dhe punëdhënësi yt nuk ndërmerr asgjë për përmirësimin e gjendjes, ke të drejtë të prishësh kontratën e punës.	Arkës së papunësisë duhet t'ia dëshmosh arsyet e prishjes së kontratës nga ana jote. Dëshmi e mirë është certifikata e mjekut apo letërkëmbimi.
AVIG 16 Reshti. 2	Nëse në vendin e punës je viktimë e racizmit, atëherë kjo punë nuk mund të kërkohet nga ti. Nëse jep anulimin, atëherë Sigurimi në rast papunësie nuk mund të shkurtojë ditët e pagesës. www.alk.unia.ch > Gesetze > AVIG	Duhet të kërkosh nga punëdhënësi, që ai të parandaloj racizmin. Vetëm nëse ai bën pak apo asgjë kundër, ke të drejtë të prishësh kontratën e punës, pa rrezikuar shkurtime të pagës nga Arka e Papunësisë.



A ia vlen ndërmarrja e hapave ligjore?

Së pari duhet parashtruar pyetja e efektit të bumerangut: cilat janë pasojat e një procesi gjyqësor? A jam i gatshëm t'i bartë këto pasoja?

Procesi gjyqësor kërkon kohë dhe kushton. Shanset për sukses varen nga rasti dhe dëshmitë: edhe nëse je 100 për qind i bindur se ke të drejtë, gjykatësi mund të vendos ndryshe. Për këtë arsye duhet ikur proceseve gjyqësore dhe ato duhet nisur vetëm nëse masat tjera si: mediacioni, dialogu, bisedimet apo marrëveshjet e ndryshme dështojnë.

Nëse rasti nuk është i qartë dhe dëshmitë nuk janë të mjaftueshme atëherë nuk duhet nxitur procesi gjyqësor. Racisti, i cili nga gjyqi shpallet i pafajshëm mund ta ndijë veten të fortë dhe të vazhdoj rrugën e tij.

Nëse rasti është i qartë dhe dëshmitë janë të mjaftueshme atëherë ia vlen procesi gjyqësor! Norma penale kundër racizmit sulmohet vazhdimisht nga racistët, të cilët duan ta anulojnë këtë ligj. Me procese të suksesshme gjyqësore mund të mbrohet kjo normë dhe të bëhet vetëdijesimi i politikës dhe masave të gjëra mbi domosdoshmërinë e kësaj norme.

Sigurimi i dëshmive: Sipas rregullit Ti duhet të dëshmosh, se racisti është sjellë apo sillet në mënyrë raciste. Për të dëshmuar këtë duhet të kesh material për dëshmim: letërkëmbim, i- mel të shtypur, dëshmitarë të besueshëm. Grumbulloji të gjitha! Kujdes: nëse dëshmi e vetme është thënia jote, atëherë shanset për sukses janë të pakta.

Adresat e rëndësishme

Këshillimoret e specializuara

Tikk – Taskforce interkulturelle Konflikte, T 044 291 65 75, www.tikk.ch

ACOR – Association Romande contre le Racisme/**SOS Racisme**

Gratis Telefon: 0800 55 44 43, Lausanne:
T 021 311 80 57, Fribourg: T 026 424 21 25,
www.sos-racisme.ch

Së bashku kundër dhunës dhe racizmit

T 031 333 33 40, www.gggfon.ch

Konfliktophon – Shërbim këshillues në rast të konflikteve mes të vendasve dhe të ardhurve si dhe viktimave të diskriminimit racial.

T 044 242 42 29, www.konfliktophon.ch

BaBeRas – Basellandschaftliche Beratungsstelle gegen Rassismus,
Oberfeldstrasse 11a, CH-4133 Pratteln

Integres – Integrationsfachstelle

Region Schaffhausen, T 052 630 06 40,
markus.pluess@sah-sh.ch

CaBi – Anlaufstelle gegen Rassismus
Verein Café-Bibliothek/CaBi Antirassismus Treff,
Linsebühlstrasse 47, CH-9000 St. Gallen,
www.cabi-sg.ch

Lista e këshillimoreve

Të radhitura sipas Kantoneve dhe gjuhëve:
www.edi.admin.ch/ara > (Anlauf & Beratung)

Lista e të deleguarve për integrim

Delegatët Kantonal për integrim ofrojnë pjesërisht
këshillime në raste të diskriminimit racial.
www.ekacfe.ch/d/adressen.asp

Diskriminimi gjatë kërkesës së vendshkollimit për ngritje profesionale

NCBI Fairness T 044 432 47 63,
fairness@ncbi.ch, www.ncbi.ch

Projekte kundër racizmit prej shkollave dhe për shkolla

www.projetscontrelracisme.ch (fr), www.projekte-gegenrassismus.ch (dt), T 031 389 20 24

Për refugjatë

Flüchtlingshilfe Schweiz Bern: T 031 370 75 75,
Lausanne: T 021 320 56 41,
Lugano: T 091 923 17 76, www.sfh-osar.ch

Formimet e mëtejme

Movendo – Kurse kundër racizmit

Kurse për njerëz të besueshëm dhe
bashkëpunëtorë të sindikatave,
T 031 370 00 70, www.movendo.ch

Fondacioni Edukim dhe Tolerancën në Cyrih

T 044 349 49 66, www.set-toleranz.ch

Fondacioni Edukim dhe Zhvillim në Bernë

T 031 389 20 21, www.globaleducation.ch

**Dua të angazhohem kundër racizmit!
Shoqata dhe grupime kundër racizmit**

Sindikata Unia

www.unia.ch/jugend > gegen Rassismus

Solidaritet pa kufi – T 031 311 07 70,
sekretariat@sosf.ch, www.sosf.ch

LICRA – T 022 312 08 12, www.licra.ch

Fondacioni kundër racizmit dhe antisemitizmit

T 044 218 50 30, www.gra.ch

Klartext – Kultura rinore kundër racizmit

(Projekte për të rinj): T 033 221 73 00,
welcome@klartext-online.ch

Augenauf – Basel: T 061 681 55 22,
Bern: T 031 332 02 35, Zürich: T 044 241 11 77,
www.augenauf.ch

Antifa – info@antifa.ch www.antifa.ch,
info@buendnis-gegen-rechts.ch,
www.buendnis-gegen-rechts.ch

**Këshillime juridike për specialist
dhe rrjetëzim i këshillimoreve**

MERS – T 031 302 01 61, www.humanrights.ch



Ne mbrohemi!

Politika armiqësore kundër të huajve dhe azilkërkuesve e qarqeve të djathta nxitë armiqësinë ndaj të huajve dhe racizmin.

Te masat e gjëra krijohet bindja e përgjithshme se të huajt janë vetëm kriminel potencial dhe refugjatë të rrejshëm. Me këtë krijohet «toka pjellore» për racist, nacionalist dhe fashist. Racizmi i fshehtë nën sipërfaqe bëhet kështu realitet normal shoqërorë.

Kundër kësaj duhet të mbrohemi. Sepse, racizmi nuk përputhet me shoqërinë tonë demokratike, të hapur dhe tolerante. Ai i/e cili/a vëren racizmin, e bën publik, e lufton dhe mënjanon, jep një kontribut të rëndësishëm në ruajtjen dhe zhvillimin e demokracisë sonë.



**Die Gewerkschaft.
Le Syndicat.
Il Sindacato.**

Für Menschenrechte

Gegen Rassismus

DER BUND FÖRdert PROJEKTE IN DEN BEREICHEN
BILDUNG, SENSIBILISIERUNG, PRÄVENTION, OPFER- UND
KONFLIKTBERATUNG.

Prodhim i Sindikatës Unia, Dega Migracion dhe Rini,
përkrahur nga Fondi i projekteve kundër racizmit dhe
për të drejta të njeriut si dhe nga Shërbimi për çështje
të rinisë pranë Ministrisë federale për sigurime
sociale. Falënderojmë Rininë sindikale të Austrisë
për fotografitë nga fushata «wirgegenurteile.at».